



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 18.6.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Arbërie Nagavci, Abdyl Salihu dhe Mufëra Shinik.

Munguan: Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, Verica Çeraniq, Albulena Balaj-Halimaj dhe Driton Çaushi.

Përfaqësues të tjerë: Edijar Krasniqi – KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 qershor 2018;**
- 3. Shqyrtim i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 qershor 2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 12 qershor 2018 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtim i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë

Ismajl Kurteshi, tha që projektligji është në fazën përfundimtare dhe parashtrori disa vërejtje lidhur me disa çështje. Ai propozoi që tek neni 5, nënparagrafi 3.3, tek fjalia “ofrimi i informatave”, të zëvendësohet me fjalën “të grumbullimit dhe të sistemimit të informatave” sepse ky Këshill duhet edhe të grumbullojë dhe sistemojë informatat.

Nezir Çoçaj, tha që fjala grumbullim nuk përfshin edhe aspektin e ofrimit të dhënave sepse duhet të kemi parasysh se ky mekanizëm duhet edhe të ofrojë të dhëna.

Ismajl Kurteshi, tha që të mbetet të fjala “të ofrimit”, mirëpo, të theksohet që bëhet “për institucionet” përkatëse e jo “nga institucionet”.

Nezir Çoçaj, tha se vlen të ceket që bëhet edhe “nga” edhe “për” institucionet.

Anëtarët e Komisionit u dakorduan që të bëhet ky ndryshim “grumbullimi dhe ofrimi i informatave për institucionet përgjegjëse”.

Ismajl Kurteshi, propozoi që tek neni 9, nënparagrafi 1.4., të vendoset përfundimisht për termin “institucion” apo “trupë”.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan të gjithë për termin “institucion”.

Ismajl Kurteshi, gjithashtu tha se tek neni 14, paragrafi 1 duhet shqyrtohet dilema për termin pronar apo posedues i dijes, meqenëse shprehja pronar të dijes nuk ekziston në fjalorin e gjuhës shqipe, mirëpo, ka njeri që posedon dije andaj ai propozoi të ndryshohet në “poseduesi i teknologjisë dhe dijes”.

Muferra Sinik, tha që sipas saj edhe termi pronar mund të ketë kuptim.

Nezir Çoçaj, tha se teknologjia mund të ketë pronar, mirëpo dija jo.

Ismajl Kurteshi, propozoi edhe që tek neni 14, paragrafi 2, tek fjalia “çdo palë që ka lejen e pronarit apo dëshminë e pronarit të një teknologjie ose lejen e dijes”, fjala “leje e dijes” të zëvendësohet me “dëshminë e dijes” sepse dijen mund ta dëshmosh me diplomë.

Arbërie Nagavci, tha që pjesa e parë e fjalisë të mbetet ashtu siç është, mirëpo, të shtohet pjesa e “dëshmisë së dijes së caktuar, për transfer” si pjesë e dytë. Ajo gjithashtu shprehu dyshimet e saj tek titulli “Transfer i dijes” pasi që sipas saj nuk mund të ketë transfer të dijes sepse ekziston mundësia e përdorimit apo shfrytëzimit të dijes, mirëpo, jo edhe transferit sepse shkelen të drejtat e poseduesit / autorit andaj ajo propozoi të mbetet vetëm “E drejta për transfer të teknologjisë” dhe jo dijes.

Nezir Çoçaj, arsyetoi që leja për dije mund të ofrohet dhe propozoi që versioni paraprak të mos pësojë ndryshime sepse mund të shkaktojë konfuzion.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që në fund të fjalisë, të shtohet “sipas ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta”, në mënyrë që të mos krijojë ndonjë paqartësi.

Kryetari i Komisionit propozoi që mbledhjen e ardhshme të votohet për amendamentet për këtë projektligj dhe të procedohen për komisione të përhershme.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisioni propozoi që në mbledhjen e radhës Komisioni të përcaktojë prioritetet e aktiviteteve të punës për sesionin pranveror.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi